## Subjektet deklarues në Prokurorinë Shqiptare dhe struktura e pagave të tyre

Kanë detyrim për deklarim periodik në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

| FUNKSIONI | STRUKTURA E PAGAVE |
|---|---|
| - **Prokurori i Përgjithshëm;** | Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 52/1 përcaktohet se "1.Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.".<br><br>Në ligjin nr. 8588, date 15.03.2000 kreu II neni 22 është përcaktuar se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është e barabartë me pagën e ministrit ndërsa ajo e Kryetarit të Gjykatës së Lartë është 20 % më e lartë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.<br><br>Në ligjin nr.9584 date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", në lidhjen nr.1 pika C/1, përcaktohet koeficenti me të cilin do të bëhen llogaritjet e pagave dhe konkretisht është 0.68 %. Ligji 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014" neni 12 parashikon se "Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj.". |
| - **Prokuror;** | Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në |

| | |
|---|---|
| | Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 52/2 percaktohet se: "Paga e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me pagën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e drejtuesve të hallkave, që janë prokurorë në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme, është 5 për qind me e lartë se paga e prokurorëve të kësaj prokurorie.". |
| - **Prokuror në Prokuroritë e Apeleve**<br>- **Prokuror në Prokuroritë Pranë Gjykatave të Shkallës Parë** | Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 52/3 përcaktohet se: "Paga bazë e prokurorit ose drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe shtesa për vjetërsi apo vështirësi në shërbim e tyre, është e barabartë me pagën dhe shtesën e vjetërsisë dhe të vështirësisë së gjyqtarit e të kryetarit të gjykatës, pranë së cilës funksionon prokuroria, ku ai është emëruar.".<br><br>Në ligjin nr.9877 datë 18.02.2008 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 27 është përcaktuar se paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit, është 75% të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.<br><br>Referuar ligjit 114/2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9877 datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 26, është përcaktuar se paga e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është 60 % e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë |
| - **Sekretar i Përgjithshëm;** | I-a VKM 545/2011 i ndryshuar |
| - **Drejtor Kabineti;** | I-a VKM 545/2011 i ndryshuar |

| | |
|---|---|
| - **Këshilltar;**<br><br>- **Kancelar;** | I-b VKM 545/2011 i ndryshuar<br><br>II-b VKM 545/2011 i ndryshuar<br><br>Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 57 përcaktohet : “Prokurori i Përgjithshëm mund të emërojë kancelarë për ndjekjen e problemeve të karakterit administrativ e financiar. Paga e tyre është e njëjtë me atë të kancelarëve pranë gjykatave.”. |